



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060-60206 dt. 18 11 2022

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **24.11.2022** (E Enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.10.2022.
2. Draft Propozim Plani i Veprimt për vitin 2023-2024, të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023.
4. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik juridik Limit Project shpk, "Rinesa" shpk në parcelën kadastrale : P-70314035-00004-124, zona kadastrale Komoran.
5. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit juridik Mehdi Gjoka, B.I, "Fer Petrol" në parcelën kadastrale: P-70315052-00140-3, zona kadastrale Çikatovë e re.
6. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik Blerim Kluna në parcelën: P-70314035-01981-0, zona kadastrale Komoran.
7. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik Habib Miftari në parcelën kadastrale: P-70314016-00034-0, në zona kadastrale Korroticë e Eperme.
8. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit juridik Rinesa Shpk- Ideal Partners shpk, BM Group, BM Group, Fer Petrol, Aktiv Residence me parcelën kadastrale: P-70315016-01032-2, zona kadastrale Glllogoc.
9. Raporti i përfundimit të Komunës së Drenasit për vitin 2021.
10. Të ndryshme.

Drenas, 17.11.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Makigj Malsore Ceqiqi
Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 17. 11.2022, si vijon:

-Pasi kryesuesi Milaim Hajdari mungoi në mbledhjen e KPF, mbledhjen e udhëhoqi Malsore Cakiqi i përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e KPF-ca, për rendin e ditës me 6-gjashtë pika shtesë, ku i pyeti të pranishmit nëse ka dikush, debat rreth pikave të rendit të ditës mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati hodhi në votim rendin e ditës.
Pjesëmarrës në mbledhje për votim ishin 6-gjashtë anëtarët e KPF-së.

- Votuan 05 Për, Kundër: 0, dhe Abstenim: 1

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20. 10.2022.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

2. Draft Propozim Plani i Veprimit për vitin 2023-2024, të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

4. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik juridik Limit Project shpk, "Rinesa" shpk në parcelën kadastrale : P-70314035-00004-124, zona kadastrale Komoran.

- Votuan 02 Për, Kundër: 04, dhe Abstenim: 00

5. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit juridik Mehdi Gjoka, B.I, "Fer Petrol" në parcelën kadastrale: P-70315052-00140-3, zona kadastrale Çikatovë e re.

- Votuan 01 Për, Kundër: 04, dhe Abstenim: 01

6. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik Blerim Kluna në parcelen: P-70314035-01981-0, zona kadastrale Komoran.

- Votuan 03 Për, Kundër: 02, dhe Abstenim: 01

7. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik Habib Miftari në parcelën kadastrale: P-70314016-00034-0, në zona kadastrale Korroticë e Eperme.
- **Votuan 02 Për, Kundër: 04, dhe Abstenim: 00**
8. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit juridik Rinesa Shpk- Ideal Partners shpk, BM Group, BM Group, Fer Petrol, Aktiv Residence me parcelën kadastrale: P-70315016-01032-2, zona kadastrale Glllogoc.
- **Votuan 02 Për, Kundër: 04, dhe Abstenim: 00**
9. Raporti i proformancës së Komunës për Drenasit për vitin 2021
- Rekomandohet për Kuvend.
10. Të ndryshme.
Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 55.



Kryesuesi i Kuvendit

Për Hatigji Malsore Cakigji
Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/04-60208 dt. 18.11. 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.10.2022**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.09.2022.
2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2022.
3. Propozim vendim për formimin e Komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve.
4. Raport nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale për realizimin e Projekteve gjatë këtij viti dhe planifikimi për tre muajt e ardhshëm.
5. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Rexhep Meidani “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
6. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Alfred Moisiu “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
7. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Bamir Topi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit
8. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z Prof. Dr. Bajram Begaj “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
9. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z. Edi Rama “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
10. Propozim vendim për shpalljen znj. Ana Roch “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit.
11. Të ndryshme.

Të enjten me dt. 27.10.2022 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 11 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, zyra e informimit, përfaqësues nga OSBE-ja- Driton Nuli. Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës. Mungoj Fatmir Baliu, Labinot Halilaj, Marigona Bazaj, me arsyetim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 27.09.2022.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, 3 kundër, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2022.**

Drin Halilaj, pati dy pyetje për Drejtorinë e Arsimit: tek subvencionet në arsim shpenzimi është shumë i ulët për dallim nga zotimet por edhe nga viti 2021 pse ka ndodh kjo? Të investimet që janë paraparë të katër projektet: inventarizimi i shkollave, furnizimi i shkollave me kabinete, digjitalizimi i institucioneve arsimore dhe renovimi i objekteve shkollore pse nuk ka fillua ende kërkoj një sqarim?

Florentina Elezi-Veliu, pati pyetje për drejtorinë e inspeksionit tek tabela e të hyrave vërejmë se ka ulje të theksuar përgjysmim për tre mujorin e njëjtë të vitit të kaluar, a mund të na sqaroni këtë dallim? Gjithashtu edhe përqindja e realizimit të projekteve kapitale vetëm 23.18 % është realizimi i buxhetit nëse e shikojmë në krahasim me 6 mujorin e vitit 2021 dhe 2022 nuk ka ndonjë dallim të madh, realizimi është shumë i ulët, kërkoj një sqarim pse?

Shyqiri Bublaku - Drejtori i Financave, sa i përket subvencioneve në Drejtorinë e Arsimit çdo herë ndahen në pjesën e fundit të vitit për studentet më të mirë, dhe kjo është praktike e viteve të kaluara, ndërsa sa i përket të hyrave vetanake nga drejtoria e inspeksionit duhet se në muajin shtator kemi pas grevë e cila ka ndikuar jo vetëm në Drejtorinë e inspeksionit por ka ndikuar në të gjitha drejtoritë në ramjen e të hyrave në muajin shtator kjo ka qenë ndikimi i drejtpërdrejt i grevës i cili ka ndikuar në realizimin e të hyrave, mirëpo nëse e shikojmë realizimin e të hyrave për këtë vit jemi shumë mirë jemi 163 % me të hyrat direkte dhe indirekte.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, subvencionet në arsim ne i shpallim në muajin kur fillojnë viti i studimeve, konkursi është shpallë dhe do të përfitojmë studentet që do ta marrin

bursën, për këtë arsye, ndërsa subvencionet në kategori tjera i shpenzojmë sipas kohës që kërkohet, shpenzimi është i vogël për shkak se deri më tani nuk është shpallë konkursi për përfitimin e bursave.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për formimin e Komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve.**

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, në bazë të rregullores u dashtë me u kufizua numri i këshillave lokale prej 44 sa kanë qenë në 25, se pari duhet të formohet komisioni i cili ky komision do të dalë në teren dhe do t'i zgjedhin kryesuesit e këshillave lokale në bashkëpunim me administrator të tanishëm në bazë të rregullores.

Azmine Bujupi-Gjoka, kërkoj me e sjellë rregulloren për me e shiku se si bëhet zgjedhja e administatoreve të fshatrave.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, ky kuvend e ka miratuar atë rregullore, dhe do ta zbatojmë ashtu siç e cek rregullorja.

Beqir Kiqina, sa i përket kësaj pike propozim vendim për formimin e komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve, ndër të tjera ka ngritur këtë çështje para legjislativit:

1. Kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane të paguhën nga Komuna e Drenasit, si formë e stimulimit për kontributin e tyre në shërbim komunitetit.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, çështjen të cilën e ngrite është shumë e rëndësishme, kur dihet që ne kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me administratorë të fshatrave, sidomos gjatë periudhës së pandemisë dhe nuk më pas mundësi me i pagu. Në bazë të rregullores tek pika e shtatë e komisionit me rregullore parashihet administoret aktual do të jenë pjesë e komisionit. Anëtarët do të jenë me rrotacion varësisht se ku do të mbahen zgjedhjet psh në Drenas anëtar i komisionit do të jetë administratori aktual, sa i përket anëtarit të shtatë si pjesë e komisionit nuk mundemi ta përcaktojmë një të vetëm mirëpo administoret aktual të secilit fshat që i ka pasur.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, anëtar i 7 i komisionit dmth mbetet administratori aktual, nga ekzekutivi për anëtar të komisionit propozoj: nënkryetarin Arben Shala, nga Shoqëria civile Shqipe Hoxha.

Bekim Lestrani- në si grup i PDK-së për anëtar të komisionit propozojmë: Fatmir Baliu.

Azmine Bujupi-Gjoka- në si grup i DD për anëtar të komisionit propozojmë: Hamit Haxhiun.

Drin Halilaj- në si grup i VV për anëtar të komisionit propozojmë: Egzona Tërdevcin.

Arbër Halilaj - në si grup i VV për anëtar të komisionit propozojmë: Beqir Kiqinen.

Me propozimet që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim.

U miratua kjo pikë e rendit të ditës me këtë përbërje të komisionit:

1. Arben Shala -anëtar nga ekzekutivi
2. Shqipe Hoxha - anëtare nga shoqëria civile
3. Fatmir Baliu - anëtarë nga Kuvendi i Komunës
4. Hamit Haxhiu - anëtarë nga Kuvendi i Komunës
5. Egzona Terdevci - anëtare nga Kuvendi i Komunës
6. Beqir Kiqina - anëtarë nga Kuvendi i Komunës
7. _____ përfaqësues nga fshati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: 4. Raport nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale për realizimin e Projekteve gjatë këtij viti dhe planifikimi për tre muajt e ardhshëm.

Endrit Gllareva- Drejtor i Infrastrukturës Lokale, Lidhur me pikën e rendit të ditës rreth raportimit për projektet kapitale të vitit 2022.

Gjate vitit 2022 situata e ngritjes së çmimeve të sidomos në materiale ndërtimore na ka efektuar në shumë kontrata megjithatë Kumuna e Drenasit respektivisht Drejtoria e Infrastrukturës Publike është duke i realizuar projektet që ishin të planifikuara për vitin 2022.

Ndërtimi dhe rehabilitimi i kanalizimit primar dhe sekondar në Drenas dhe fshatra përreth janë realizuar rreth 12000 metra me diametër të gypit fi 250 dhe fi 315 të cilët shërbejnë për lidhje primare dhe sekondare në lagje të ndryshme në komunën tonë ndërsa në proces janë edhe 8000 metra tjera.

Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujarëve të zeza kanë përfunduar rreth 4000 metra nga gjimnazi në drejtim të fshatit Dobroshec dhe në proces janë edhe 3000 metra.

Urat dhe tombinat janë në realizim e sipër kanë përfunduar ura në Poklek të Vjetër dhe Dobroshec lagjen Hajdari është duke u realizuar ajo, në lagjen Avdyli në proces janë edhe 3 tombina dhe një vig për këmbësor në Poklek të Vjetër.

Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës Besim Mala janë duke u zhvilluar punimet në zgjerimin e rrugës në 3 korsi ku në projekt është edhe trotuari edhe shiriti për biçikleta.

Infrastruktura në Drenas në të cilën kemi paraparë asfaltimin e pargingut të hekurudha i cili do të shërbejë për 350 parkinge si dhe rregullimi i shtigjeve për biçiklist, kontrata është lidhur dhe gjatë javës së ardhshme priten fillimet e punimeve.

Asfaltimi i segmenteve rrugore:

Tërdec- janë asfaltuar 8 segmente rrugore edhe në proces janë edhe 5 segmente tjera, është duke u asfaltuar edhe rruga Terdec-Vuqak.

Gllanasellë janë asfaltuar 10 segmente rrugore në proces janë edhe 4 segmente.

Në bashkësinë lokale të Dobroshecit janë duke u zhvilluar punimet në ndërtimin e bazamenteve rrugore në 8 segmente dhe 15 tjera janë në proces

Zona e Komoranit me fshatrat përreth janë duke u realizuar 45 segmente rrugore në ndërtimin e bazamentit për asfaltim.

Zona e Tërstenikut me fshatrat përreth janë në proces 30 segmente rrugore dhe pritet të fillojnë me realizimin e bazamentit për asfaltim.

Ne shtrirjen e rrjetit të ujesjellsit jemi duke punuar në pastrimin edhe izolimin e rezervarit në Kamenicë ku shpresojmë që shumë shpejt do të lëshohet uji i pijes në drejtim të Terstenikut dhe Gllanaselles me fshatrat për rreth.

Ndriqimin public e kemi kontratën në OSHP dhe shpresojmë që sa më shpejt të merr një vendim organi shqyrtues.

Jane renovuar 4 shkolla Korroticë e Eperme, Komoran, Drenas I dhe II. Është rinovuar edhe **stadioni sintetik** në proces janë edhe rregullimi i zhveshtorve në stadionin “Regjep Regjepi” si dhe janë 4 fusha sportive në fshatrat e komunës tonë.

Egzona Tërdevci, pyeti: kërkesat që do t’i paraqes i kam paraqit edhe me herët mirëpo për të fundit nuk kam marrë ende përgjigje, email-in e kam dërguar nga dt. 14.10.2022, tek lagjja Zhushi në Verboc përkatësisht rruga “Imer Zhushi” që vjen në drejtim të lagjes Istogu ka mbetur e pa asfaltuar rreth 1 km rrugë, po ashtu rruga “Martiret e Istogut” nga Lagjja Istogu në drejtim të fshatit ka mbet pa asfaltua, e ceke që në fshatrat Tërstenik me fshatrat përreth do të asfaltohen disa segmente rrugore, a janë edhe këto rrugë të përfshirë në ato segmente që do të asfaltohen. Po ashtu kam bërë kërkesë për një rrugë në fshatin Gllobar e kam shkruar një imell në shkurt të vitit 2022, kam marrë përgjigje se do të shikojmë mundësit buxhetore dhe do t asfaltohet nëse ka mundësi, është kërkesë nga banoret e lagjes Terdevci në fshatin Gllobar rruga “Behram Morina” a kam perfundu kjo rrugë gjatë vitit 2022, në email e keni pasur edhe foton e bashkangjitur, çështja tjetër është për kolektorë e ceket që për kolektorë janë përfudnu rreth 4 mije metra punë, ne në këtë kuvend kemi ndarë edhe mjete shtesë, unë e kam shikuar kontratën për vitin 2022 janë të parapara vetëm 40 dit pune sipas planit dinamik, a ka përfunduar puna apo ka mbet ende punë pa kry për kolektorët sa i përket vitit 2022.

Endrit Gllareva-Drejtore i Infrastrukturës Lokale, shumë shpejt do të merr përgjigje në lidhje me kërkesat e parashtruara, lidhur me rrugë që pyete janë projekte të vitit 2023, nuk janë për vitin 2022, sa i përket kolektorëve për grumbullimin e ujerave të zeza është një projekt që kuhton jashtëzakonisht shumë, 4 km i kemi përfunduar, dhe do të vazhdojmë me punimet deri sa ta përfundojmë dhe impiantin e ujerave të zeza, kolektorët do të vazhdojnë edhe 3 vitet e ardhshme.

Egzona Tërdevci, sa i përket rrugëve po e marr si zotim publik që janë projekte të vitit 2023.

Arbër Halilaj, si e kanë tejkaluar problemin kryesor të kësaj periudhë të vështirë që po e kalojmë, shkak i ngjitjeve të çmimeve, operatorët e kanë problem të operojnë kontratat aktive si jeni ballafaquar me këtë problem, a keni kontrata nga të cilat janë tërheq operatorët ekonomik?

Endrit Gllareva-Drejtore i Infrastrukturës Lokale, viti 2022 është vit me i vështirë edhe se viti pandemik sa i përket realizimit të projekteve, për momentin janë larguar dy kompani kanë heq dorë nga kontrata që ishin për vitin 2021-2022.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Drenasit, ky vit është i vështirë jo vetëm për komunën tonë mirëpo për të gjitha komunat për shkak të krizës në Ukrainë dhe ngritjes së çmimeve.

Mehedin Salihu, këtu shkruan shumë mirë, asfaltimi i rrugës Shtuticë-Polluzhë-Verboc, në fshatin Verboc janë bërë disa investime, ndërsa në rrugët e fshatit Polluzhë - Shtuticë nuk është shtruar as një metër asfalt. Pati një ankesë nga një qytetar Fadil Veliqi që ujerat e zeza dhe kanalizimi i shkon në oborr dhe ende nuk është ndërmarrë asgjë.

Endrit Gllareva-Drejtor i Infrastrukturës Lokale, të Fadil Veliqi ky projekt ka pas me përfunduar në vitin 2020 mirëpo kemi pas pengesa, dhe tani sa jemi të informuar që janë zgjidh këto probleme dhe shpresojmë që gjatë këtij viti ta përfundojmë këtë projekt. Tek investimet Shtuticë-Polluzhë-Verboc realisht këtë vit në këto fshatra nuk kemi mundur të punojmë sepse kontrate kornizë nga viti 2021 në vitin 2022 kanë ngec punimet mirëpo tani kemi filluar kontratën e re dhe shumë shpejt do të fillojmë me punimet.

Drin Halilaj, rruga nga shkolla e fshatit Baicë e deri te udhëkryqi që i lidh fshatrat Baicë-Tërdevc- Abri është shumë e frekuentuar prej nxënësve në atë pjese nevojitet një trotuar urgjent për shkak që mos të rrezikohet jeta e nxënësve, a është e paraparë që se paku këtë vit me fillu ky trotuar?

Endrit Gllareva-Drejtor i Infrastrukturës Lokale, trotuari në fshatin Baicë –Tërdevc, në drejtim të Abrisë e kemi pas të paraparë në vitin 2021-2022 kontrata ka ngec për shkak të ngritjeve të çmimeve shpresojmë që me 20 % e ngritjes nga qeveria edhe kompania do të filloj punimet.

Beqir Kiqina, pyeti: sa keni qenë në bashkëpunim ndërinstitucional me Ministrinë e Financave apo me qeverinë sepse janë zotuar që kanë me e përkrahë komunat për shkak të ngritjes së çmimeve. Kërkoj nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale të bëjë përpjekje që t'i realizoj projektet sipas planit dhe zotimeve siç janë paraparë.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Drenasit, kontraktuesit që kanë lidh kontrata me insitucionet publike prej marsit e deri me tani, ende është në projekt ligj nuk është miratuar në kuvend ende, edhe për ata nuk po i kryen shërbimet kompanitë, çështja e suficit është çështja që neve na brengos më së shumti, sepse nëse ne nuk i kalojmë investimet kapitale mbi 75 % grandet si shpenzojmë ne nuk mund të jemi në garë për grand të performances, dmth na humbin 2 vite nëse nuk mund t'i realizojmë.

Egzona Tërdevci, projektligji që e përmendet vlen për kontratat që janë nënshkruar para muajit prill të vitit 2022, kontratat që janë nënshkruar pas prillit të vitit 2022 u dashtë ta kenë parasysh ngritjen e çmimeve, sepse situata me çmime po shkon në favor të ngritjes së çmimeve, me e bere krahasimin e gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 dhe vitit 2022 në vlerë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2022 janë realizuar më shumë mjete se sa vitin 2021 dmth që Drenasi nuk koka prek shumë prej krize në kuptim të vlerës së investimeve kapitale në krahasim të gjashtë mujoreve. E ceket që dy kompani janë tërheq nga kontrata i përmende emrat e projekteve, cilat janë ato kompani që janë tërheq dhe në çfarë kohe janë nënshkruar kontratat?

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Drenasit, ishte fjala për kontratat që janë lidhë para muajit mars dhe për ato që kanë filluar punët prej muajit prill, sepse në muajin mars asnjë kompani nuk mundet të filloj punën për shkak të kohës. Sa i përket kompanive që nuk i kanë përfunduar punët mirë apo nuk i kanë kry punët fare e kanë kontrata me komunën ia kemi dërguar organit shqyrtues prokurimit publik dhe ende nuk i ka vë në listë. Ne nuk kemi të

drejtë me i bërë publike kompanitë të cilat janë tërheq nga kontrata por e cekem që në ndërtimin e fushave sportive.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë deri tek pika e dhjetë e rendit të ditës:

1. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Rexhep Meidani “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
2. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Alfred Moisiu “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
3. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Bamir Topi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit
4. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z Prof. Dr. Bajram Begaj “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
5. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z. Edi Rama “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
6. Propozim vendim për shpalljen znj. Ana Roch “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit.

Arbër Halilaj, Pikat 5 deri 10 janë të njehta dmth. janë propozime për shpalljen Qytetar Nderi të personaliteteve të nderuara. Kuvendi Komunal, në këtë rast me propozimin e Kryetarit, bazuar në Ligjin e V.L. dhe Statutin e Komunës, ka të drejtë të propozojë dhe të aprovojë Vendime për titujt e nderit, në mesin e tyre edhe për shpalljen Qytetar Nderi, siç po kërkohet në seancën e sotme. “Qytetar nderi” është titulli apo statusi më i lartë i nderit që një qytet apo komunë i akordon një personaliteti, i cili me veprimtarinë e shquar, angazhimin e tij të pashoq, trimërinë, sakrificën, arritjet shkencore apo mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit të Drenasit, ka bërë shumë në dobi të Komunës sonë dhe banorëve të saj. Ky titull nderi i jepet në shumë raste edhe personaliteteve të huaja të nivelit të lartë, që kanë kontribut të jashtëzakonshëm për qytetin tonë në veçanti dhe kombin shqiptar në përgjithësi, e që zakonisht jepet në ceremoni solemne në kuadër të një vizite zyrtare të personalitetit të dekoruar.

Zakonisht, titulli “Qytetar Nderi” nuk bart me vete ndonjë çmim monetar apo vlerë tjetër, duke mos i dhënë kështu kurrfarë ndryshimi statusit shoqëror të individit të shpallur “Qytetar Nderi”, pra ka vetëm vlerën e çmuar simbolike. Ky titull natyrisht duhet të shoqërohet me një arsyetim të veçantë lidhur me laureatin e këtij titulli dhe meritat e tij, në mënyrë që qytetarët të dijnë rreth jetës dhe veprimtarisë së atij që po i bëhet ky nderim publik.

Por, procedurat e zakonshme në këto raste e kërkojnë që ne së pari të përpilojmë dhe aprovojme një “Rregullore të KK Drenas mbi dekoratat dhe titujt e nderit”, ku do të përcaktoheshin të gjitha kriteret, të drejtat dhe mënyrat e propozimit dhe ndarjes së titujve të nderit, në raste të caktuara edhe mënyra dhe kriteret e abrogimit të titujve, si dhe procedura e tërësishme që duhet ndjekur që nga propozimi e deri tek marrja e titullit në ceremoni zyrtare. Në këtë aspekt, me qëllimin për të mos lejuar politizimin dhe dhënien në mënyrë të pajustificuar të këtyre titujve, e drejta e propozimit do t’i përkiste përveç Kryetarit të Komunës, edhe çdo anëtar i Kuvendit Komunal dhe po ashtu të mundësohet edhe propozimi nga qytetarët, me listë të nënshkrimeve drejtuar institucioneve, për një personalitet të caktuar e të argumentuar plotësisht.

Po ashtu, për të zbatuar këtë Rregullore dhe për të shqyrtuar propozimet dhe arsyetimet për të njejtat, duhet të formohet një Komision Vlerësues për ndarjen e titujve dhe dekoratave, i

përbërë nga anëtarë Kuvendi dhe shoqëria civile, që në prizmin e kriterëve dhe rregullave për vlerësimin e personaliteteve me merita dhe kontribut të veçantë për komunën tonë, do të rekomandonte aprovimin apo refuzimin e propozimeve që vijnë, tash dhe në të ardhmën.

Në Rregullore do të përcaktohej edhe mundësia e krijimit të titujve të tjerë, për të shprehur mirënjohjen e posaçme për veprimtarinë e shquar të personaliteteve në dobi të komunitetit të Drenasit, meqë titulli Qytetar Nderi mendoj se duhet të jipet shumë rrallë. Titujt tjerë të mundshëm, bashkë me emrat e tyre (këto vetëm si propozim do t'i them) do të ishin: Nderi i Qytetit-titulli më i lartë pas atij Qytetar Nderi, titulli me emrin "Fehmi e Xhevë Lladrovci" për kontribut të veçantë në veprimtari ushtarake, politike dhe diplomaci; titulli "Ymer Elshani" për personalitetet më të shquara të kulturës, artit dhe letërsisë, të dëshmuar me arritjet e tyre në nivel kombëtar e ndërkombëtar; Titulli për arritje dhe promovim të sportit dhe rinisë-që do ta emërtonim në të ardhmen; titullin për aktivizim qytetar; titullin për shërbim në komunitet, si dhe Mirënjohje e Falënderime të KK Drenas, me të cilat në raste festive nderohen personalitete, shoqata e institucione, të cilat kanë dhënë kontribut të veçantë e të rëndësishëm në fusha të ndryshme në të mirë të komunitetit tonë.

Për të dëshmuar se sa rrallë jepet ky titull në qytete të caktuara dhe sa i veçantë është si çmim, të shohim disa statistika nga rajoni:

- Shkupi nga viti 1921 deri më 2018, pra për gati 10 dekada, ka shpallë vetëm 16 veta si Qytetar Nderi.
- Spliti poashtu për 100 vjet, nga viti 1921 e deri me 2021 ka shpallur vetëm 12 vetë.
- Qyteti i Zagrebit nga viti 1853 dhe deri më sot, pra për 170 vite, ka shpallur vetëm 50 qytetarë nderi.
- Sarajeva për 18 vite, nga viti 2000 deri më 2018 shpalli vetëm 5 qytetarë nderi.
- Në Shqipëri Bashkia e Shkodrës ka shpallur rreth 150 vetë, afërsisht sa ç'ka shpallë p.sh.: Viena nga viti 1797 e deri më sot.

Faktet e cekura më lart e dëshmojnë se "Qytetar Nderi" duhet të jetë një titull shumë i veçantë e që jepet shumë rrallë, siç e ceka më lartë, vetëm për personalitete emblematike dhe të merituar, në mënyrë që të mos devalvohet vlera e këtij titulli. Shumë funksionarë politik e institucione tek ne shqiptarët janë treguar dorëlira në dhënien me e pa kriterë të këtij titulli nderi.

Për këtë arsye, sot në fakt unë po kërkoj që Komuna jonë të dallohet për të mirë në këtë aspekt, duke e vënë në binarë këtë çështje përmes Rregullores dhe kriterëve strikte brenda saj. Përndryshe, sa i përket personaliteteve të propozuara dhe veprimtarisë së tyre në interes të popullit dhe shtetit tonë, nuk kam aspak dilema se a duhet apo jo të shpallen Qytetar Nderi të komunës sonë, por pavarësisht kësaj, edhe në këtë proces duhet të miratojmë dhe zbatojmë rregulla. Pra, jam kundër kësaj mënyre dhe procedure, e jo kundër personaliteteve të cekura. Poashtu, rastet dhe vendimet e kësaj që janë mbipartiake dhe kanë të bëjnë me titujt e nderit, duhet të përcillen me koordinim, unitet dhe dakordim pozitiv-opozitiv, që do të duhej ta iniconte propozuesi, pikërisht edhe nga fakti që nuk kemi rregullore dhe komision të formuar për këtë çështje.

Përndryshe, secili nga ne kemi ide e propozime që të shpallim dikënd Qytetar Nderi apo kandidat për tituj të tjerë dhe për të mos pasur dilema, situata tifoze politike e debat të panevojshëm, ju sygjeroj që këto propozime për Qytetar Nderi, që nuk bartin në vete kurrfarë urgjence, të procedohen në Asamble pasi të kemi përpiluar së pari Rregulloren për PROCEDURAT, MENYRAT DHE KRITERET PËR NDARJEN E TITUJVE TË NDERIT, të cilën si Draft ofrohem vullnetarisht që ta përpiloj sa më parë ose si pjesë e një grupi punues,

pastaj formohet *Komisioni për ndarjen e Dekoratave dhe titujve të nderit*, i cili në bazë të asaj Rregulloreje do të shqyrtonte dhe aprovonte propozimet që kemi para vetes, si dhe çdo propozim tjetër në të ardhmën.

Nëse ky sygjërim apo kërkesë injorohet dhe procedurat kryhen pa Rregullore dhe Komision, me urgjencë dhe pa bashkëpunim të sinqertë, atëherë i bie që jemi duke e kryer një formalitet dhe jemi duke ia ulur edhe vlerën titullit si të tillë, prandaj në çdo situatë të kështillë unë do të abstenoja nga tërë procesi ose do të votoja parimisht kundër, mirëpo duke e respektuar biografinë, vlerat dhe kontributin e secilit prej tyre, jo vetëm për komunitetin tonë por për kombin në tërësi, unë jam pro kalimit të këtyre propozimeve.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Drenasit, komisioni ka qenë i formuar por asnjëherë nuk ka kry punën e vet, nga muaji i ardhshëm mund të jetë si pikë e rendit të ditës, për me e formu komisionin e ri sepse nuk janë më ata anëtar pjesë e asamblesë dhe mund ta formojmë komisionin për rregullore për dekorata dhe tituj nderi.

Pas diskutime, kryesuesi hodhi në votim nga pika e pestë deri tek pika e dhjetë e të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme.**

Drin Halilaj, tek pika e dytë të raporti financiar nuk u përgjigj Drejtori i Arsimit, të investimet kapitale që ishin të katër projekte inventarizimi i shkollave, furnizimi i shkollave me kabinete, digjitalizimi i institucioneve arsimore dhe renovimi i objekteve, ende nuk kanë filluar këto projekte kërkoj një sqarim.

Egzona Tërdevci, ne si grup i asamblistëve i kemi përgatitur disa çështje që na janë dërguar nga qytetaret e Drenasit lidhur me Drejtorinë e Arsimit. Lidhur me asistentet me nevoja të veçanta, në disa shkolla fëmijët me nevoja të veçanta po ndjekin mësimin bashkë me disa nxënës të tjerë, meqë ata kanë më shumë nevojë për kohë dhe për procesin e të nxënës, kjo po ju shkakton vështirësi edhe nxënësve me nevoja të veçanta edhe nxënësve të tjerë por edhe për mësimdhënësve, ne kemi informata që janë pranuar shtatë asistentë në shtator për shtatë shkolla mirëpo sa është mbuloshmëria që ata mundën me ofru shërbime përveç këtyre shtatë shkollave? Sa i përket zëvendësimit të orëve të humbura gjatë grevës, a janë duke u zëvendësuar në të gjitha shkollat e komunës sonë orët e humbura të mësimi, pra zëvendësimi a po behet ditëve të shtunë. Në shkollat që po zëvendësohen orët e humbura si po behet njoftimi që të shtunave po mbahet mësimi meqë nga shkollat po marrim informacion që SBASHK-u nuk po i lejon që për vazhdim të mësimit nuk po i lejon t'i publikojnë njoftimet në ëueb faqe të shkollave. Për fshatin Nekoc nga një prind i fshatit Nekoc kemi pranuar shqetësim lidhur me mbajtjen e mësimit ditën e shtunë sipas informatave që kemi marrë të shtunën e parë që ka qenë e planifikuar zëvendësimi i mësimit në shkollë ka qenë vetëm drejtori shkollës stafi teknik dhe pak nxënës, kjo gjetje është evidentuar edhe nga inspektorët e arsimit i cili ka qenë në vizitë në shkollë atë ditë, të shtunën e dytë të planifikimit të zëvendësimit të orëve në shkollë kanë qenë disa mësimdhënës ka pasur numër më të madh të mësimdhënësve mirëpo nxënësit kanë qëndruar në shkollë vetëm deri në ora 12 dhe nuk kanë mbajtur mësim fare. Shkolla Filllore në fshatin Nekoc nuk ka mësimdhënës të fizikes nga muaji qershor e tutje. Kërkoj sqarim se sa mësimdhënës janë aktualisht në pushim pa pagesë. Sa i përket furnizimit me lëndë djegëse për institucionet arsimore në Drenas, e kam shikuar

që në shtator të këtij viti u shpall tender për furnizimin me dru për institucionet arsimore në Komunën e Drenasit dhe ka qenë kontratë kornize për 36 muaj, në paramasë ka qenë e shkruar se 10 % e furnizimit të behet në muajin tetor, ky tender është anuluar për shkak se ka kandidu vetëm një firmë dhe ajo firmë ka qenë më çmim më të lartë se sa vlera e zotuar, a posedojnë shkollat rezerva të lendeve djegëse në situatën që moti ndryshon, pra nëse kemi ftohje të motit a rrezikohen mos të mbahet mësimi në ndonjë shkollë për shkak që shkollat nuk janë furnizuar më kohë me lëndë djegëse, ne kemi marrë një informacion se në shkollën Filllore të Baicës nxënësve të klasës së parë ju janë kërkuar mjete financiare që t'i blejnë disa dru për ngrohje. Pati dhe një kërkesë për Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjente, ne kemi pranuar ankesa nga banoret e banesave sociale në Drenasin III se po kanë shqetësime lidhur me qentë endacak po ashtu po kanë probleme edhe me ndriçim a jeni ne dijeni të këtyre çështjeve nëse jo a mund t'i trajtoni?

Muhamet Gjoka, Drejtori i Arsimit- lidhur me projektet të cilat i përmendet ju njoftoj se të gjitha janë në proces, furnizimi me kabinetet vetëm ka përfunduar, renovimi i shkollave ka përfunduar, inventarizimi është në proces të vlerësimit javën tjetër lidhet kontrata, digjitalizimi po ashtu është në proces, shpresojmë që deri në muajin dhjetor të përfundojnë të gjitha këto projekte. Mungesa e mësimdhënësve me nevoja të veçanta e kemi përfunduar procesin dhe i kemi angazhuar tre asistent për fëmijë me nevoja të veçanta ky ka qenë planifikim i ministrisë së Arsimit ku çdo vite angazhohen 100 mësimdhënës mbështetës, neve na kanë takuar vetëm 3 asistent, ne jemi munduar t'i mbulojmë të gjitha shkollat, dhe pothuajse të gjitha shkollat kanë asistentë mbështetës mirëpo me angazhim 1 -2 ditë varësisht prej rasteve varësisht prej epikës vlerësuese për fëmijë me nevoja të veçanta. Nga janari i vitit të ardhshëm kemi mundësi me i angazhua edhe 6 asistent dhe ne do të fillojmë më procedurë qysh në muajin dhjetor të këtij viti. Sa i përket zëvendësimit të orëve të humbura ne po sa kemi pranuar kalendarin për ta rishikuar për zëvendësimin e orëve të humbura i kemi përcjell nëpër shkolla dhe shkollat kanë qenë të obliguara t'i njoftojnë nxënësit dhe mësimdhënësit njoftohen se duhet zëvendësohen orët e humbura. Në disa shkolla janë mbajtur pjesërisht, në disa shkolla u bë zëvendësimi i orëve komplet. Sa i përket mësimdhënësit të fizikës e kemi pas në konkurs kemi shkuar në rishpallje për shkak se nuk kemi pas mësimdhënës adekuat që kanë aplikuar për mësimdhënës të fizikës, mirëpo tani pasi ka dal konkursi në rishpallje kemi mundur të pranojmë sepse në rishpallje edhe me një kandidat mund të vazhdojmë procedurën sipas udhëzimit administrativ, javën e ardhshme do të fillon një mësimdhënës në lëndën e fizikës. Sa i përket numrit të mësimdhënësve që kane kërkuar pushim pa pagesë sigurisht që ne konsultohemi me udhëzime administrative dhe ua mundëson që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë me arsytim. Sa i përket furnizimit me lëndë djegëse ka qenë procedurë tenderuese kontrata me furnizim me lëndë djegëse ne e kemi pas një operator që na ka furnizuar deri me 16 tetor me lëndë djegëse, shumicën e shkollave i kemi të furnizuara me lëndë djegëse në shkollën e Nekocit nuk është e furnizuar. Sa i përket shkollës së Baicës nuk kam informacione të tilla dhe nuk besoj se është e vërtetë.

Lumnije Krapit- Drejtoreshë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Komuna e Drenasit e ka të nënshkruar një marrëveshje me fondacionin Stray-Coco fondacion i Zvicrës, ne e kemi hedh numrin kontaktues të veterinarit në ueb faqen e komunës gjithashtu e kemi njoftuar edhe Policinë e Kosovës po ashtu kemi kërkuar në ueb faqen e komunës të gjithë ata që kane kërkesa lidhur me këtë çështje munden me i adresuar edhe ne Drejtorinë e Shërbimeve Publike e pastaj ne i adresojmë tek personi kontaktues të cilën e kemi nënshkruar kontratën. Sa i përket ndriçimit publik të gjithë qytetaret ta parashetrojnë kërkesën apo ankesën në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe ne e kemi ekipin që del në teren i verifikon

gjendjen lidhur me çka është, gjithashtu e kemi kompaninë kontaktuese që merret me mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

Egzona Tërdevci, ne çdo herë po kemi pyetje dhe problematika tek të ndryshmet drejtuar drejtoreve të komunës, a mundemi me e bërë çdo herë në seanca si praktik një pikë të ndarë të rendit të ditës pyetje drejtuar drejtoreve edhe në këtë mënyrë i kishim drejtuar pyetjet dhe i kishim dërguar më herët më shkrim dhe kish me qenë me e qartë për drejtoret.


Arbër Halilaj, pati një ankesë nga disa mjek, në një konkurs i cili është zhvilluar gjatë muajit tetor koordinator i cilësisë dhe sigurisë në shërbime shëndetësore në QKMF në Drenas, ku shihet që kandidatet aplikues asnjë nuk e ka kaluar pragun e 50 % e pikëve të testit dhe konkursi nuk është rishpall mirëpo sipas mjekeve që me janë drejtuar, është emëruar dikush në atë pozitë aty a jeni në dijeni për këtë dhe çfarë mund të ndërmerrni në këto raste.

Arsim Haxhiu - Drejtor i Shëndetësisë, qarkorja informative 01/2020, kush është punëtor shëndetësor i përcakton nocioni i ligjit është mjeku , specialisti apo infermieri, çështja e procedurës se testimit dhe kriterëve që i përcakton komisioni janë të tilla të cilat min. Duhet të jetë 50 % e testit për me e kalu në këtë rast ka pas tërheqje të dy doktorëve duke menduar se kanë të drejt vetëm doktorët dhe natyrisht konkursi i brendshëm duhet përsëritur.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:58 min .


Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 27.10.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalën YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



01-Nr 400/01-58467 dt. 09/11/2022

DRAFT PROPOZIM

PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2023 -2024 TË

STRATËGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020 - 2024

NËNTOR 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (i) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt. e Republikës së Kosovës"), nenit 34.6 pika të Statutit të Komunës së Drenasit; me nr; 01-110-6904 të dt; 24.09.2008, Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimi i Statutit të Komunës së Drenasit me nr: 12-030-19523 të dt;06.04.2018, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.04/2018 për Transparencën në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dispozitave të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës si dhe Strategjisë së Zhvillim Ekonomik Lokal 2020-2024 të Komunës së Drenasit, dispozitave të Rregullores (QRK)Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dispozitave të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 08.11.2022 të aprovoj:


PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2023 -2024 TË

STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Plani i veprimit parasheh buxhetimin për vitin 2023-2024 i bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 dhe rekomandimeve nga MAPL.


Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 është 5 vjeçare ndërsa plani i veprimit të saj ka qenë 3 vjeçare me rekomandim nga MAPL dhe MFPT është hartuar plani i veprimit për periudhën e mbetur 2022-2024 të dokumentit strategjik.


Kryetari i Komunës
Ramiz Eladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT

01- NR. 052-57486
Drenas me : 03.11.2022



PËR:	Zyrën e Kryetarit të Komunes së Drenasit z.Ramiz Lladrovci
NGA:	Ekipi Komunal për Planit të Veprimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Drenasit për periudhën afatmesme 2023-2024
LENDË	Raport i punës

R A P O R T

Sipas vendimit të Kryetarit të Komunes së Drenasit 01 nr. 030/01-25045 të datës 30.06.2022 ekipi komunal ka hartuar draft Planin e Veprimit për vitet 2023-2024 të SZHEL, i bazuar në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 - 2024 (Drenas)


Plan ky i veprimit u hartua nga anëtarët e ekipit komunal të cilët kanë inkorporuar të dhënat sipas fushave të drejtorive përkatëse.

Rrjedha dhe mbarëvajtja në të gjitha hapat e realizimit të këtij plani është mbikëqyrur nga koordinatori i këtij plani strategjik shumë të rëndësishëm komunal.









Realizimi i hartimit të planit të veprimit ka rrjedhur si në vijim:

- Takimi informues me të gjithë anëtarët e ekipit komunal e caktuar;
- Udhëzimi për sigurimin e të dhënave të dërguara sipas departamenteve-drejtorive për hartimin e planit strategjik të mbështetur në objektiva të SZHEL 2020-2024;
- Realizimi i punëtorisë një ditore si dhe
- Futja e të dhënave në draftin final të planit të veprimit për secilin sektor sipas të dhënave të dërguara nga secili anëtar i ekipit komunal.

Anëtarët e Ekipit Komunal për Hartimin e Planit të Veprimit për vitet 2023-2024 të SZHEL 2020 - 2024 (Drenas) janë:

1. Egzona Jetullahi – Gjoshi, Drejtori i DZHE-s 
2. Shehrije Mustafa – Koordinator 
3. Besim Tahiraj – Anëtar 



4. Vlora Gjinoftci – Anëtare .
5. Besart Bajrami – Anëtar .
6. Antigona Durmishi – Anëtare .
7. Shukrije Azizi – Anëtarë .
8. Arbësa Dobra – Anëtare .
9. Flora Thaqi – Anëtar .
10. Agim Kastrati – Anëtar .
11. Ahmet Ahmeti – Anëtar .
12. Defrim Nika – Anëtar .
13. Shkendije Thaqi – Anëtarë .
14. Haki Bekolli – Anëtar .
15. Violeta Baleci – Anëtare .
16. Hazir Elshani – Anëtar .
17. Bekim Dobra – Anëtar .
18. Arben Kuliqi – Përfaqësues i bizneseve)- Anëtar .
19. Nexhmedin Bala (Shoqëria Civile) – Anëtar .

Raportit i bashkangjitet Draft Plani i Veprimit për vitet 2023-2024 të SZHEL, i bazuar në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 - 2024 (Drenas)

Komuna e Drenasit ::: Plani Strategjik dhe Operacional
Ky plan operacional paraqet projektet për dy vite (2023-2024)

Plani strategjik					Plani implemen tues		Monitorimi	Buxheti		
					Periudha kohore					
					Fillimi	Mbarimi	Indikatorët Kyç të Performancës	Vetë- financim	Donatorët	Total
Qëllimet dhe Nën- qëllimet Strategjike		Objektivat	Përgjeji ës							
